

AKT THEMELIMI

PER SHOQERINE ANONIME "KLODI" SH.A. F I E R

Ne qytetin e Fierit, sot me date 4.09.1999, te poshteshenuarit:

1. YLLI XHEVDET BRAKA, i vitlindjes 1958, lindur ne Fier dhe banues ne rrugen "Deshmoret e 4 shkurtit" pallati 10, hyrja e Tirane, me kombesi e shtetesi shqiptare;

2. KOSTA ANASTAS QIBUQI, i vitlindjes 1957, lindur dhe banues ne Menidi - Arta Greqi, me kombesi e shtetesi greke;

3. ILIAZ ISA FISHEKU, i vitlindjes 1956, lindur dhe banues ne Fbrostar Ura Fier, me kombesi e shtetesi shqiptare;

vendosem te themelojme nje shoqeri anonime ne perputhje me kerkesat e ligjit 7638 date 19.11.1992, ligjit 8450 date 24.2.1999 dhe dispozitave te tjera ligjore ne fuqi, ne kushtet vijuese:

Neni 1

Themelohet Shoqeria Anonime pa oferte publike, me emertimin "KLODI" e shenuar shkurt "KLODI" SH.A.

Qendra dhe selia e saj ndodhen ne qytetin e Fierit, ne adresen: Lagjja "29 nentori" nr.60.

Kjo shoqeri tregtare mund te krijojte degje te saj edhe ne qytete te tjera te Shqiperise.

Neni 2

Shoqeria tregtare "Klodi" sha eshte person juridik shqiptar dhe veprimtaria e saj do te kryhet ne pajtim me legjislacionin shqiptar ne fushen e perpunimit, transportit dhe tregtimin e naftes dhe gazit, si dhe ne gjithe aktivitetin e vet juridiko-civil.

Neni 3

Objekt i veprimtarise se saj do te jete:


Tregtimi me shumice i naftes bruto e te perpunuar, i gazit natyror, benzines se automjeteve, nenprodukteve te tjera te lengshme si: benzol, gazoil, ksilol, vajguri ndriqes, vajra lubrifikante, solare, bitum, mazut etj te kesaj natyre, import-eksport.

Shoqeria mund te krijojte apo marre pjese ne shoqeri te tjera te shitjes me pakice te karburanteve.

Neni 4

Veprimtaria e shoqerise tregtare "Klodi" sha do te zgjate me akt te papercaktuar. Veprimtaria e saj do te filloje mbas rregjistrimit ne rregjistrin tregtar prane Gjykates se shkalles se pare Tirane, rregjistrimit ne organin tatinor dhe marrjes se lejes se tregtimit ne dika-steria qe mbulon hidrokarburet.

Neni 5



Kapitali themeltar i shoqerise tregatare "Klodi" SHA Fier eshte 2.000.000 (dymillione) leke dhe perbehet krejtesisht nga kapitali para i shlyer plotesisht. Ky kapital eshte i ndare ne 30 (njetete) aksione nominative te se njejtës kategori, prej te cilave: 8 (tete) aksione i zotron Kosta Çibuqi ; 8 (tete) aksione i zotron Ylli Braka dhe 4 (kater) aksione i zotron Iliaz Fisheku.

Vlera nominale e aksionit eshte 100000 (njqindmije) leke.

#### Neni 6

Ortaket perballojne humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar. Ata mbajne pergjegjesi per shkeljet e fajshme qe kane sjelle deme ne veprimtarine ekonomike financiare te sha "Klodi" Fier.

#### Neni 7

Te ardhurat qe rezultojne nga veprimtaria e sh a mbas zbritjes se detyrimeve, do te perfitohen prej ortakeve Kosta Çibuqi, Ylli Braka dhe Iliaz Fisheku, ne raport me kapitalin themeltar te investuar nga secili.

#### Neni 8

Afati i veprimtarise mbaron me plotesimin e kohes se parashikuar ne kontrate. Ortaket mund te zgjatin afatin e veprimtarise se shoqerise ose mund te heqin dore, sipas kushteve te lejuara nga statuti perpara perfundimit te afatit.

Veprimtaria e kesaj sha mbaron edhe ne rastin kur nuk fiton, rifiton apo humbet te drejten e lincimit.

#### Neni 9

Ortaket kane keto detyrime kryesore:




- rregjistrim dhe marrje licese per fillim te veprimtarise.
- sigurimi i pajisjeve per kapacitetin minimal te depozitave dhe aparatet matese te kalibruara.
- sigurimin e specialisteve dhe personelit drejtues administrativ.
- nenshkrimin e kapitalit themeltar te shoqerise.

#### Neni 10

Organet drejtuese te shoqerise anonime "Klodi" Fier jane:

- Asambleja ( e zakonshme ose jashtezakonshme) e ortakeve (aksionareve).
- Keshilli mbikeqyres.
- Drejtoria.
- Per kontrollin e te ushtruarit ligjor te aktivitetit caktohet

dispoziti kontabel i autorizuar



jne sekretin e krijimit, te veprimtarise si dhe faktet e percaktuara si sekret te shoqerise. Ata mbajne pergjegjesi ne rastet kur vertetohet se i jane shkaktuar deme shoqerise prej mosrespektimit me dashje apo nga pakujdesia i kesaj dispozite.

Neni 12

Per menyren e organizimit, te drejtimit dhe kontrollin e veprimtari se se shoqerise, do te mbeshtet ne statutin e sha "Klodi" Fier, ne ligjin "Per perpunimin, transportimin e tregtimit e naftes, gazit dhe nen-produkteve te tyre", ligjin "Per hidrokarburet" dhe ligjet e tjera ne fuqi qe lidhen me aktivitetin e saj.

Neni 13


Mosmarveshjet qe nuk mund te zgjidhen ne pajtim brenda shoqerise tregtare, si dhe midis saj e te treteve, zgjidhen nepemjet rruges gjyqesore. Gjykata kompetente sipas percaktimeve te bera ne Kodin e Procedures Civile te Republikes se Shqiperise.

Ky akt themelimi mbasi u lexua prej secilit ortak nenshkruhet me vullnet te lire te tyre ne prani te noterit.

Nje kopje e tij se bashku me nje kopje te statutit dhe akteve te tjera depozitohet prane Gjykates se shkalles se pare te rrethit gjyqesor Tirane.

ORTAKET THEMELUES TE  
SHOQERISE TREGTARE " KLODI " SH.A. FIER

1. YLLI BRAKA
2. KOSTA ÇIBUQI
3. ILIAZ FISHEKU



PER SHOQERINE TREGTARE "KLODI" S H A FIER

Ne Fier, sot me date 4.9.1999, themeluesit e kesaj shoqerise:  
1. Ylli Xhevdet Braka, i vitlindjes 1958, lindur ne Fier dhe  
banues ne rr. "Deshmoret e 4 shkurtit" pallati 10, hyrja 2, 11 fane;

2. Kosta Anastas Gibuqi, i vitlindjes 1957, lindur dhe banues  
ne Menidi Arta Greqi;

3. Ilias Isa Fisheku, i vitlindjes 1956, lindur dhe banues ne  
Mbrogstar Ura Fier;

ne perputhje me ligjin 7638 date 19.11.1992, ligjin 8450 date  
24.2.1999 dhe legjislacionin ne fuqi, hartojme kete statut per organizi-  
min, drejtimin dhe kontrollin e veprimtarise se shoqerise.

## I. BAZA LIGJORE

## Neni 1

Shoqeria tregtare me emrin "Klodi" SHA Fier rregullon poziten  
juridike te themeluesve, te organeve drejtuese te saj, marredheniet me  
te punesuarit si dhe persona te trete, ne pajtim me ligjin 7512 date  
10.8.1991, ligjin 7638 date 19.11.1992, ligjin 8450 date 24.2.1999 dhe  
legjislacionin shqiptar ne fuqi.

## II. EMRI

## Neni 2

Emertimi i plote i shoqerise eshte: Shoqeria Anonime "Klodi"  
Fier, ndersa i shkurtuar eshte: "Klodi" Sh.A. Fier. Ajo eshte shoqeri  
tregtare shqiptare dhe ka statusin e personit juridik shqiptar. Eshte  
shoqeri anonime pa oferte publike.

Ne te gjitha aktet ose dokumentet e shpallura nga shoqeria, te  
destinuara per te tretet, shenohet emri i shoqerise, vlera e kapitalit  
themeltar dhe emrat e anetareve te drejtorise dhe kryetarit te Keshi-  
llit Mbikqyres.

## III. KOHEZGJATJA

## Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te paparcaktuar dhe llog-  
aritja e ketij afati fillon nga dita e rregjistrimit te shoqerise ne  
rregjistrin tregtar. Brenda ketij afati shoqeria pushon veprimtarine e  
saj me vendim te mbledhjes se asamblese se jashtezakonshme ose ne  
rastet e tjera te prishjes se shoqerise qe parashikohen ne statut.

## IV. SELIA

## Neni 4

Shoqeria e ka qendren e vet ne qytetin e Fierit, ne adresen: Lagja  
"29 nentori" nr.60. Ajo mund te krijojte degje edhe ne rrethe te tjera.

## V. OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë se shoqërisë do të jetë:- Tregtim me shumicë i naftës bruto e të perpunuar, i gazit natyror, benzines së automjeteve, nënprodukteve të tjera të lëshme si: benzol, gazoil, ksilol, vajguri ndri-  
qës, vajra lubrifikante, solare, bitum, mazut etj të kësaj natyre, import-  
eksport.

Shoqëria mund të krijojë ose të marrë pjesë edhe në shoqëri të tjera të shitjes me pakicë të karburanteve.

Neni 6

Veprimtaria e shoqërisë do të zhvillohet në përputhje me kerkesat e ligjit "Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", ligjin "Per hidrokarburet", ligjin "Per transportin rrugor" dhe legjisllacionin tjetër në fuqi.

#### VI.KAPITALI THEMELTAR DHE NDRYSHIMET E TIJ

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë tregatë "Klodi" SHA Fier është 2.000.000 (dymilione) leke dhe përbehet krejtësisht nga kapitali para i shlyer plotësisht. Ky kapital është i ndarë në 80 (njetëzetë) aksione nominative të së njëjtes kategori, prej të cilave: 8 (tete) aksione i zotron Kosta Çibuqi ; 8 (tete) aksione i zotron Ylli Braka dhe 4 (kater) aksione i zotron Iliaz Fisheku.

Vlera nominale e aksionit është 100000 (njëqindmijë) leke.

Zvoglimi i kapitalit themeltar me një vlerë më të vogël se vlera minimale e përcaktuar në ligj (2 milionë leke, sipas nenit 75 të ligjit 7638 datë 19.11.1992) bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar, të pakten deri në vlerën minimale. Përndryshe shoqëria prishet.

Neni 8

Kapitali duhet të nënshkruhet plotësisht, Shlyerja e vlerës së mbetur behet me një apo më shumë keste, sipas vendimit të drejtorisë.

Aksionet në natyrë shlyhen plotësisht në momentin e nënshkrimit.

Aksionet nuk mund të përfaqësojnë kontribute në shërbime.

Neni 9

Nënshkrimi i aksioneve për kontributin në para evidencohet në një buletin të vecantë. Fondet që rezultojnë nga nënshkrimet për kontributet në para, si dhe lista me emra, mbiemra, adresat e banimit të nënshkruesve dhe shumat e derdhura nga secili prej tyre, depozitohen në një noter ose në banke për llogari të shoqërisë në formim e sipër.

Cdo nënshkrues vëhet në dijeni të listës dhe mund të marrë një kopje kundërt pagesës.

Neni 10

Nënshkrimet dhe shumat e derdhura evidentohen nga një certifikatë

qe leshohet nga mbajtësi i fondëve, e hartuar ne momentin e depozitimit mbi bazën e buletineve të nënshkrimit,

Neni 11

Kapitali themeltar zmadhohet nepermjetemitimit të aksioneve të reja ose nepermjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese.

Aksionet e reja shlyhen me para ne dore ose menyra të tjera pagese. Zmadhimi i kapitalit nepermjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve behet vetem me pelqimin unanim të aksionereve, me perjashtim të rastit kur ai realizohet ne perfshirje të rezervave të fitimeve apo primeve të emetimit.

Neni 12

Zmadhimi i kapitalit themeltar e vendos vetem mbledhja e asamble se të jashtezakonshme.

Zmadhimi i kapitalit themeltar duhet të kryhet brenda 5 vjeteve nga data kur ka vendosur asambleja.

Neni 13

Kapitali duhet të jete shlyer teresisht para se të jete bere emetimi i aksioneve të reja qe shlyhen me para ne dore, perndryshe operacioni konsiderohet i pavlefshem.

Neni 14

Aksionet japin të drejte perparesie nënenshkrimit per rritje të kapitalit. Aksioneret kanë të drejte perparesie në nënshkrimit per rritje të kapitalit me para ne dore proporcionalisht me shumën e aksioneve qe zotrojnë. Ata mund të heqin dore nga kjo e drejte vetem individualisht.

Neni 15

Aksionet per kontributet në natyre shlyhen plotesisht sapo të emetohen.

Neni 16

Zvoglimi i kapitalit autorizohet ose vendoset nga asambleja e jashtezakonshme, e cila mund të japë drejtorise të gjitha të drejtat per ta realizuar.

Ne çdo rast zvoglimi i prekt aksioneret në të njëjten mase në perpjestim me vlerën e aksioneve qe zotrojnë. Zvoglimi i kapitalit mund të kundërshtohet në gjykate.

Zvoglimi i kapitalit per çfardo shkaku qofte në një shumë me të vogël se minimumi ligjor, mund të vendoset vetem me kushtin pezullues të një zmadhimi të kapitalit, të destinuar të çoje kete të fundit të pakten në minimumin ligjor.

Ne rastin e mosrespektimit të kesaj dispozite, çdo i interesuar mund të kerkoj nga gjykata kompetente prishjen e shoqerise. Prishja e shoqerise nuk mund të shpallet në se ditën kur gjykata shqyrton çështjen, përveç nëse është anuluar.

Blerja e aksioneve te veta prej shoqerise eshte e ndaluar.

## VII.AKSIONET

Neni 18

Aksionet paraqiten detyrimisht ne formen e aksioneve nominative.

Pronesia e aksioneve rezulton nge rregjistrimi i tyre ne emer te titullarit ose te titullareve ne librin e aksioneve te mbajtura prej shoqerise ose ndemjetesve financiare.Ky liber aksionesh do te pëmbaje ne çdo kohe informatat qe percaktojne numrin dhe kategorine e aksioneve daten e marrjes nga aksioneret,emrin,mbiemrin dhe adresen e cdo aksioneri si dhe vleren nominale per cdo aksion te zoteruar.

Neni 19

Secili aksioner ka te drejten te kerkoje me shkrim dhe te marre n nje ekstrat nga libri i aksionereve,i cili vertetohet me vulen e shoqerise.Secili prej tyre ka te drejten te verifikojë ne se emri tij eshte futur ne librin e aksionereve dhe personi i cili mban librin eshte i detyruar t'i tregojë aksionerit,me kerkesen e ketij te fundit hyrjen perkatese ne liber.

Neni 20

Per transferimin e pronesise se aksioneve nominative nje personi te trete jepet pelqimi i shoqerise.Ne rastin e trashgimise ky pelqim nuk kerkohet.

Shoqeria jep pelqimin brenda 3 muajeve nga data e paraqitjes se kerkeses prej pronarit,te cilit i transferohet pronesia.

Neni 21

Ne rastin e zmadhimit te kapitalit,aksionet jane lirisht te tregtueshme pas realizimit te ketij zmadhimi.

Pas prishjes se shoqerise(likujdimit) aksionet mbeten lirisht te tregtueshme,deri ne mbylljen e likujdimit.

Neni 22

Ndryshimet e pronesise se aksioneve nominative si rrjedhoje e nj nje shitjeapo e nje transferimi,kryhen nepemjet nje kalimi nga llogaria e dhenesit tek llogaria e marresit ne baze te nje urdher xhirimi.Shoqeria eshte e detyruar te kryeje kete rregjistrim dhe kete xhirim brenda 6 diteve nga marrja e urdher xhirimit.

Urdher xhirimi i pergatitur me nje formular te dhene nga shoqeria ose te miratuar nga shoqeria nenshkruhet nga dhenesi i aksionit ose perfaqesuesi i tij.Ne se aksionet nuk jane shlyer teresisht urdherxhirimi nenshkruhet edhe nga marresi.

Neni 23

Transferimi i aksioneve falas si rrjedhoje e trashgimise,kryhet gjithashtu me anen e kalimit ne llogari,baze te nje dokumenti i rrejor

qe verteton transferimin.

Shpenzimet per transferimin e aksioneve jane ne ngarkim te blyerit perveg, rastit te nje marrevashje te kundert midis dhenesit dhe maresit.

Aksionet e pashlyera per derdhjet e kerkuara nuk mund te pranohen me transferim.

Neni 24

Aksionet e nenshkruara lidhur me zmadhimin e kapitalit te shoqerise duhet te shqyrtohen sipas modaliteteve te caktuara nga asambleja e jashtezakonshme. Shlyerja e ketyre aksioneve nuk mund te jete me e ulet se 1/4 e vleres minimale dhe ne se eshte rasti e teresise se primeve te emisionit.

Shlyerja e vlefites minimale te mbetur duhet te kryhet ne nje ose disa keste, me kerkesen e drejtorise se shoqerise, ne nje afat prej 5 vjetesh nga data kur ky zmadhim i kapitalit eshte bere perfundimtar.

Kerkesa e fondeve per shlyerjen e aksioneve u behen te njohura nenshkruesve te pakten 15 dite para dates se caktuar per çdo derdhje, me leter rekomande, me kthim pergjigje per marrjen ne dorezim, te adresuara te çdo titullar i aksioneve.

Çdo vonese ne derdhjen e shumave te duhura nga shumat e pa shlyera te aksioneve sjelle pagimin e interesave me pergjigjet ligjore dhe kjo pavaresisht nga veprimi personal, qe shoqeria mund te ushtroje ndaj aksionerit qe nuk ka shlyer detyrimin dhe masat e zbatimit te detyruar te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

#### VIII. AKSIONERET

Neni 25

Aksioneret e shoqerise jane persona fizike ose juridike vendas ose te huaj, qe kane vene ose do te vene ne zotrim aksione te shoqerise me vere menytrat e parashikuar ne ligj.

Pronesia mbi aksionet e shoqerise perrban aderimin ne te, me te drejta te plota ne statutin e shoqerise nepermjet perfaqesimit ne asamblene e aksionereve.

Neni 26

Çdo aksioner i saj ka te drejten e pjesmarrjes ne fitimet e shperndashme te shoqerise ne perputhje me aksionet e tij si dhe sipas vleres nominale te zoteruar prej tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Çdo aksioner ka te drejte te marre kur eshte rasti, nje pjese ne teprica e likuidimit te shoqerise ne te njejtin perpjestim, sipas paragrafit te pare te ketij neni.

Aksioneret kane te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne asamblene e aksionereve sipas kushteve te parshikuara ne kete statut dhe ne legjislacionin ne fuqi.

Aksioneret jane voto pergjegjies per detyrimet e hyrshmet e

e shoqerise deri ne kufirin e vleres vlerinale te aksioneve qe sotrojne.  
n Cdo aksioner ka te drejten e blerjes dhe te shitjes se aksioneve  
ne baze te ketij statuti dhe legjislacionit ne fuqi.

Te drejtat dhe detyrimet e aksionerit ndjekin aksionin ne çfardo  
forme, qe ai tjetersohet tek te tretet.

#### IX. ORGANET DREJTUESE

Neni 27

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Asambleja (e zakonshme apo e jashtezakonshme) e aksionereve;
- Keshilli mbikqyres;
- Drejtoria;

Ne sherbim dhe per kontrollin ligjor te punes se ketyre organeve  
caktohen ekspertet kontabel.

#### ASAMBLEJA E AKSIONEREVE

Neni 28

Asambleja e aksionereve mbledhet ne dy forma: - Si asamble e jasht  
zakonshme dhe si asamble e zakonshme.

Asambleja e jashtezakonshme merr ato vendime qe percakton statuti  
i shoqerise a po ligji, sikurse jane ndryshimi i statutit te shoqerise,  
zmadhimi dhe zvoglimi i kapitalit themeltar te shoqerise dhe çdo vendim  
tjeter i percaktuar ne dispozitat perkatese.

Neni 29

Ne mbledhjet e asamblese se jashtezakonshme mund te marre pjese  
çdo aksioner.

Asambleja e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme ve-  
tem ne rast se aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zotrojne ne mb-  
ledhjen e pare te pakten 1/2 e aksioneve dhe ne te dyten 1/4 e aksioneve  
me te drejte vote. Ne mungese se ketij quoriumi, mbledhja e dyte e asamblese  
mund te shtyhet per nje date te mevonshme, jo me larg se dy muaj.

Asambleja e jashtezakonshme merr vendim me nje shumice votash prej  
3/4 qe u perkasin aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar.

Neni 30



Asambleja e zakonshme merr çdo vendim me nje shumice votash, per-  
veç atyre ne kompetence te asamblese se jashtezakonshme.

Neni 31

Per te marre pjese ne mbledhjen e asamblese se zakonshme, aksioneri  
duhet te zotroje jo me pak se 10 aksione. Aksioneret qe kane me pak se  
ky numer, mund te bashkohen duke arritur kete numer dhe te perfaqesohen  
nga njeri prej tyre.

Neni 32

Aksioneri mund te perfaqesohet nga nje tjetër aksioner ose nga



bashkeshorti. Mandati jepet per nje mbledhje asambleje, deri ne perfundim te rendit te dites pavaresisht nga seancat e saj.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres, anetarat e drejtorise dhe ekspertet kontabel te autorizuar mund te marrin pjese ne te gjitha mbledhjet e asamblese se aksionereve me vota konsultative.

Neni 33

Vendimet e asamblese se zakonshme jane te vlefshme ne mbledhjen e pare, kur aksioneret e pranishem zotrojne 1/4 te aksioneve me te drejte vote, Ne rast se kjo nuk realizohet ne mbledhjen e dyte nuk kerkohet asaje lloj quoriumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumice votash, qe zotrojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

Neni 34

Asambleja e zakonshme thirret ne mbledhje te paketen nje here ne vit, brenda 6 muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar. Ky afat mund te zgjatet me vendim gjyqesor.

Neni 35

Drejtoria u ve ne dispozicion 15 dite perpara aksionereve dokumentet e nevojshme qe tu jape mundesi te japin nje gjykim te plote mbi administrimin dhe ecurine e puneve te shoqerise.

Neni 36

Asambleja e zakonshme shqyrton raportin vjetor te drejtorise dhe keshillit mbikqyres, inventaret, bilancin financiar vjetor, llogarite vjetore dhe ne rast se shihet e nevojshme dhe llogarite e konsoliduara.

Ekspertet kontabel te autorizuar paraqesin raport per kryerjen e detyres se ngarkuar.

Asambleja vendos per gjithë coshtjet financiare te vitit financiar qe ka kaluar dhe te dhena te tjera.

Autorizon emitimin e obligacioneve dhe nxjerrjen e akteve te veçanta te sigurimit qe lidhen me to.



Neni 37

Asambleja vendos mbi vleresimin e pasurise qe i takon cdo aksioneri dhe qe ka 1/10 e kapitalit themltar, kur ajo mbas vleresimit nga eksperti, blihet nga shoqeria brenda dy vjeteve nga rregjistrimi i saj.

Neni 38

Mbledhja e asamblese thirret nga Keshilli Mbikqyres ose nga drejtoria. Ajo mund te thirret gjithashtu nga ekspertet kontabel dhe nga mandatmbajtesi i caktuar nga gjykata ose te nje ose disa aksionerev qe zotrojne se bashku te pakten 1/10 e kapitalit themletar si dhe nga likujduesi.

Neni 39



ne nje gazete te autorizuar per publikim njoftimeve ligjore.

Ne rastet kur aksionet jane nominative njoftimi dergohet me leter rekomandimi ne adresen e cdo aksioneri me shpenzimet e shoqerise. Njoftimi duhet te vijere ne doren e aksionerit, te pakten 15 dite para dates se mbledhjes.

Neni 40

Rendi i dites percaktohet nga autori i lajmerimit. Nje apo disa aksionereve qe perfaqesojne 5 perqind, u njihet e drejta per te futur ne rendin e dites disa projektrezoluta.

Asambleja nuk shqyrton ceshtje qe nuk jane perfshire ne rendin e dites. Per shkarkimin dhe zevendesimin e anetareve te Keshillit Mbikqyres ajo mund te procedoje ne çdo rrethane.

Rendi i dites nuk mund te ndryshoje ne lajmerimin e dyte.

Neni 41

Ne çdo mbledhje te asamblese plotesohet nje evidence pjesmarrese; ecuria e mbledhjes pasqyrohet ne procesverbal.

Neni 42

E drejta e votes qe rrjedh nga zotrimi i aksioneve, eshte proporcionale me pjesen e kapitalit qe ato perfaqesojne dhe çdo aksion te jepen te drejten e te pakten nje vote.

Kushtet ne baze te cilave aksionmbajtesit mund te ushtrojne te drejten e votes ne asamble percaktohen ne ftesen per te marre pjese ne asamblene e aksionmbajtesve per çq kohe sa nuk jane dhene çertifikatat e aksioneve.

Neni 43

Kryetari i asamblese zgjidhet unanimisht nga aksioneret. Ne rast se kryetari i asamblese nuk eshte caktuar unanimisht nga asambleja, atehere kryetari asamblese do te jete kryetari Keshillit Mbikqyres.

Kryetari drejton asamblene dhe vendos mbi vazhdimesine, objektet e procedimit dhe menyren e votimit.

Neni 44

Asambleja formon nje forum ne se jane perfaqesuar te pakten 25% e aksioneve ne te drejte vote. Ne qofte se perfaqesimi me pak 25% thirret menjehere nje mbledhje e dyte, e cila nuk mban parasysht perfaqesimin e aksioneve me te drejte vote, ne se kjo pike eshte percaktuar ne lajmerimin me perjashtim te rasteve kur per marrjen e vendimit te hartuar ne rendin e dites kerkohet me ligj mazhorance me e larte. Vendimet e asamblese merren me shumicen e 10 votave, me perjashtim te rasteve kur ligji percakton nje mazhorance te thejste te kapitalit themltar.

Rezultati i votes mund te percaktohet me ane te metodes se zbritjes se votave "po" ose "jo". Te shprehurit te votave te aksionerit.

jtava te lejuara ne total.

Ne se mazhoranca e thjeshte 50% nuk arrihet me votimin e pare atehere ndermjet personave qe kane marre numrin me te madhe te votave do te shillohet nje votim deciziv. Ne rastin e barazimit te votave ne balancimin e dyte, do te hidhet short.

Neni 45

Ne asamblene e aksionmbajtesve do te merren aktet materiale, te cilat do te firmosen nga noteri dhe kryetari i asamblese.

#### KESHILLI MBIKQYRES

Neni 46

Keshilli Mbiqyres perbehet nga 3 anetare. Per çdo ndryshim te mundeshen numri anetareve dohet te jete i plotpjestueshem me 3. Asnje anetare i tij nuk mund te jete anetar i drejtorise. Anetaret e pare te Keshillit Mbiqyres te caktuar ne statut jane:

1. Emira Braka - kryetar
2. Samet Haxhijaj - anetar

Neni 47

Nga numri i pergjithshem i anetareve te Keshillit Mbiqyres 2/3 emrohen nga asambleja e aksionereve. Anetaret e pare te kesaj shoqerie jane caktuar ne nenin e mesiperm.

Kohezgjatja e anetareve te Keshillit Mbiqyres te caktuar ne statut eshte 3 vjet, ata qe emrohen nga asambleja eshte 1 vit. Ata mund te rizgjidhen. Mund te shkarkohen ne çdo kohe nga asambleja.

Neni 48

Si anetar i Keshillit Mbiqyres mund te emrohet edhe nje person juridik, i cili cakton nje perfaqesues te perhershem, qe mban pergjegjesi civile apo penale si anetar i keshillit mbiqyres.

Neni 49

Mepunesit e administrates shtetore nuk mund te jene anetare te me shume se 3 Keshilla Mbiqyres, ndersa personat fizike ne me shume se 8 te tille, sikurse perfaqesuesit e personave juridike ne me shume se 5 Keshilla Mbiqyres.

Neni 50

Ne rastin kur mbeten bosh vendet ne Keshillin Mbiqyres nga vdekja apo doreheqja e njerit prej anetareve, ky keshill mund te beje emerime te perkohshme per periudhen midis dy mbledhjeve te asamblese. Emerimet e Keshillit Mbiqyres i nenshtrohen ratifikimit ne mbledhjen e radhes se asamblese se zakonshme.

Neni 51

Nga teresia e anetareve te Keshillit Mbiqyres 1/3 e tyre zgjidhet nga radhet e te punesuarve ne shoqeri. Kur ky numer eshte me shume se dy, kuadrot dhe personat qe barazohen ne te kane te palten nje

Neni 52

Perveç rastit kur shoqëria ka me pak se dy vjet qe eshte formuar antaret e Keshillit Mbikqyres te zgjedhur nga te punesuarit, duhet te kenë nje kontrate pune te pakten dy vjet perpara dates se emrimit.

Neni 53

Te punesuarit zgjidhen anetare te Keshillit Mbikqyres me votim te fshete te te gjithë te punesuarëve te shoqërisë, te cilet kane lidhur kontraten e punes mbi tre muaj perpara dates se zgjedhjeve.

Zgjedhjet behen me votim mazhoritar me dy turse ose me lista propocionale. Ne rast barazimi votash kandidati qe ka kontraten me te vjeter te punes konsiderohet fitues.

Neni 54

Kohezgjatja e mandatit te anetarit te zgjedhur nga te punesuarit eshte 1 vit, me mandat te perseritshem.

Neni 55

Anetari i Keshillit Mbikqyres i zgjedhur nga te punesuarit eshte i papajtueshem me çdo mandat tjeter.

Neni 56

Shperblimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres te zgjedhur nga te punesuarit nuk mun te pakesohet nga fakti qe ushtrojne mete mandat.

Neni 57

Prishja e kontrates se punes i jep fund mandatit te anetarit te Keshillit Mbikqyres te zgjedhur nga te punesuarit.

Anetaret e zgjedhur nga te punesuarit mund te shkarkohen vetem per faje ne ushtrimin e mandatit te tyre dhe me vendim gjykate. Vendimi ekzekutohet perkohesisht deri sa te marre forme te prexe.

Neni 58

Kontrata e punes se nje anetari te Keshillit Mbikqyres te zgjedhur nga te punesuarit shpallet e pridhur vetem me vendim gjykate, perjashto rastin kur ajo prishje behet me kerkesen e tij.

Neni 59

Vendi bosh i nje anetari te keshillit mbikqyres te zgjedhur nga te punesuarit plotesohet: - nga zevendesuesi kur zgjedhja eshte bere mazhoritare dhe - nga numri rendor i mepasem i listes kur zgjedhja eshte bere me sistemin proporcional.

Neni 60

Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te japin doreheqje me nje del la rate me shkrim, e cila duhet te dergohet Kryetarit te keshillit mbikqyres, duke respektuar nje limit kohe prej dy javesh.

Neni 61

Keshilli Mbikqyres zgjedh nga gjiri i tij nje kryetar dhe nje zevedeskryetar.

Ne qofte se kryetari ose zevendesit i tij lirohen para mbarimit te afatit do te kryhen zgjedhje tjeter per perludhen e mbetur nga koha e ushtrimit te detyres se personave qe jane liruar. Ne pamundesi zgjedhje keto detyra kryhen nga anetari me i vjeter ne moshe.

Drejtori i shoqerise merr pjese ne mbledhje te keshillit mbikqyres pa vote vendimore.

Kryetari e zevendesit nuk mund te zgjidhen nga perfaqesues te personave juridike. Keshilli Mbikqyres cakton ne se do shperblimin e Kryetari dhe zevendesit.

Neni 62

Keshilli Mbikqyres merr vendime te vlefshme kur jane te pranishem 1/2 ant areve te tij. Vendimet e tij merren me shumice te thjeshte votash te antareve te pranishem ose perfaqesuesve te tyre.

Vota e kryetarit eshte percaktuese ne rast rezultati votimi baras.

Neni 63

Asambleja e aksionereve mund ta caktojte antareve te Keshillit Mbikqyres nje shperblim nje shume vjetore fikse per pjesmarrjen e tyre ne seancat e ketij Keshilli. Jepet si pagese ne fund te vitit financiar. Anetaret e Keshillit Mbikqyres kane te drejte te marrin shpenzimet qe kryejne ne plotesim te detyres.

Neni 64

Keshilli Mbikqyres mund t'i jape njerit ose disa antareve te drejtorise kompetencen e perfaqesimit te shoqerise. Ankesat dhe kerkesat te treteve jane te vlefshme kur i derohen drejtorit.

Neni 65

Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll te vazhdueshem per administrimin e shoqerise. Ka te drejten te kryeje ne cdo koha verifikimet dhe kontrollet qe ai qmon te arsyeshme dhe te kerkoje njohje ne dokumente qe e gjykon te nevojshme per plotesimin e detyres.

Te pakten nje here ne tre muaji drejtoria duhet te paraqes raport para keshillit mbikqyres. I paraqet brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar llogarite vjetrore sipas rastit llogarite e konsoliduara.

Neni 66

Deklarata ne emer te Keshillit do te jepen nga kryetari dhe mungese te tij zevendeskryetari. Jepen me shkrim dhe ne baze legjislacionit.

Neni 67

Mbledhja e Keshillit Mbikqyres thirret me shkrim nga kryetari dhe pamundesi ardhje nga zevendesit i tij. Lajmerimi behet 15 dite para.

Secili nga anetaret e tij mund te shtroje ceshtje ne rendin e dites, te cilat duhet ti behen te njohura kryetarit me anen e nje letre te pakten 10 dite para mbledhjes. Te gjitha anetaret informohen pa vendos

Ne se gjithë anetaret e keshillit mbikqyres jane ftuar ne kohen e duhur dhe ne se te pakten gjysma e numrit legal te tyre merr pjese ne miratimin e nje rezolute, atehere keshili mbikqyres formon nje forum.

Mbledhja drjtohet nga kryetari dhe ne se nuk eshte i pranishem ai nga zevendesi i tij. Kryetari vendos radhen e rendit te dites, llojin dhe radhen e votimit.

Procesverbalet e mbledhjes se keshillit mbikqyres, duhet te pergatiten dhe nenshkruhen nga drejtuesi perkates i mbledhjes.

Neni 69

Anetaret e Keshillit Mbikqyres duhet te ruajne informacionin konfidencial dhe sekretet e shoqerise, per te cilet jane bere te vetdijshem neper mjet detyres. Mbetet e vlefshme edhe pas largimit nga detyra.

#### DREJTORIA

Neni 70

Shoqeria anonime "Klodi" drejtohet nga drejtori e perbere nga nje anetar. Drejtor caktohet z. Ylli Braka. Drejtoria ushtron funksionet nen kontrollin e keshillit mbikqyres.

Neni 71

Anetaret e drejtorise dhe drejtori emrohen nga keshilli mbikqyres. A mund te emrohen edhe jashte bashkesise se aksionereve.

Neni 72

Kohezgjatja e anetarit te drejtorise eshte 6 vjet. Anetaret e drejtorise shkarkohen ne waste se konstatohet paaftesia e tyre ne kryerjen korrekt te funksionit, kur assembleja humbet besimin te ata dhe ne rast faji te rende.

Shkarkimi mbetet ne fuqi derisa vendimi gjyqesor per pavlefshmerine tij ka marre forme te prere.

Neni 73

Menyra dhe masa e shperblimit te secilit anetar te drejtorise. Drejtoria vepron ne cdo rrethanene emer te shoqerise, perjashto ato kompetenca qe u njihen organeve te tjera te shoqerise.

Neni 74

Anetaret e drejtorise jane pergjegjes individualisht per demet qe sjellin shoqerise nga shkeljet e statutit, dispozitave ligjore dhe fajeve te tjera gjate administrimit te shoqerise.

#### EKSEPRETET KONTABEL

Neni 75

Shoqeria mund te caktoj eksperte kontabel per cdo vit financiar, te cilet emrohen nga assembleja e zakonshme. Ekspert i pare kontabel eshte zoti Kastriot Haxha. Asambleja e zakonshme emron edhe zevendes ekspert kon



Ekspertit kontabel te autorizuar.

Ekspertet kontabel te autorizuar mbajne pergjegjesi per demet qe i shkaktojne shoqerise nga pasaktesia e mbajtjes se llogarive dhe nga verifikimi i gabuar i tyre, si dhe per shqyrtimin e rregullshmrine e tyre.

Themeluesit, anetaret e drejtorise dhe keshillit mbikqyres, personat e afert te tyre deri ne shkallen e katert te gjinise dhe krushqise, bashkeshortet e tyre, drejtuesit e filialeve dhe te zyrave nuk mund te ngarkohen me detyren e ekspertit kontabel te autorizuar.

Neni 76

Nje ose disa aksionere qe perfaqesojne 1/10 e kapitalit themletar brenda 30 diteve nga dita e caktimit, mund te kundërshtojne ne gjykate ekspertet kontabel te autorizuar te emruar nga asambleja dhe te kerkojne nga asambleja emrimin e eksperteve kontabel te autorizuar, qe te ushtrojne funksionet ne vend te tyre.

Neni 77

Ne rast gabimi ose pengimi eksperti kontabel i autorizuar shkarkohet nga asambleja e aksionereve.

Neni 78

Eksperti kontabel ka keto detyra:

- garanton qe llogarite vjetore te jene te rregullta.
- pershtatjen e kontabilitetit me legjislacionin ne fuqi.
- perputhja e informacioneve te dhena ne raportin e administrimit

me llogarite vjetore.

Neni 79

Ekspertet kontabel mund te ndihmohen edhe nga eksperte te tjere ose bashkepunetore qe i zgjedhin vete, duke ia bere me pare te njohur shoqerise.

Neni 80

Ekspertet kontabel njoftojne asamblene e aksionereve per verifikimet qe kane kryer dhe sondazhet qe kane bere.

Neni 81

Ekspertet kontabel paguhen me honorare.

**K.DISPOZITA TE PERGJITHSIME**

Neni 82

Marreveshjet qe behen ndemjet nje antari te drejtorise ose keshilli mbikqyres dhe nje shoqerie, kerkojne autorizimin paraprak te keshillit mbikqyres.

Neni 83

Ekspertet kontabel te autorizuar paraqesin raport lidhur me keto marreveshje ne asamble, e cila merr vendim.

Neni 84

Anetaret e drejtorise dhe anetaret e keshillit mbikqyres...

Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page.



...perfaqesues te personave juridike, ndalohen te kontrahojane,  
te marrin huaz nga shoqeria, te japin nepermjet saj paradhenie, si dhe te  
behen dorezenes apo te garantojne nepermjet saj detyrimet ndaj te tretve.  
Neni 85

Anetaret e drejtorise, keshillit mbikqyres dhe personat qe ftohen  
te marrin pjese ne mbledhjen e organeve, duhet te ruajne fshahtesine e te  
dhenave me karakter te brendshem.

**XI. MARREDHENIET E PUNES**

Neni 86

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me marre-  
veshjen per themelimin e shoqerise, dispozitat e statutit te saj dhe legji-  
slacionin shqiptar te punes.

Neni 87

Punesimi ne shoqeri behet sipas kontrates individuale dhe kolek-  
tive te punes.

**XII. SHNDRRIMI, NDARJA, BASHKIMI DHE LIKUIDIMI**

Neni 88

Shoqeria anonime nuk mund te shndrrohet ne nje shoqeri te nje fo-  
rme tjeter.

Neni 89

Bashkimi dhe ndarja e shoqerise vendoset nga asambleja e jashte-  
zakonshme me nje shumice votash prej 3/4 qe iu perkasin aksionereve te  
pranishem ose te perfaqesuar.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim te shoqerise qe  
zhduket dhe kalimin e plote te trashgimise se saj ne shoqerite perfituese,  
ne gjendjen ne te cilen ndodhet kjo trashgimi ne daten e realizimit perfun-  
dimitar te operacionit.

Neni 90

Shoqeria priset automatikisht ne perfundim te afatit sipas  
statutit ose nuk fiton, rifiton apo humbet te drejten e licenses.

Ne rast se asambleja e jashtezakonshme nuk mblidhet ose nuk shpall  
prishjen e shoqerise, cdo interesuar mund te kerkoje prishjen e saj ne  
rruge gjyqesore.

Neni 91

Ne se si rrjedhim i humbjeve te konstatuara ne dokumentet konta-  
bele kapitalet e shoqerise behen me te vogla se gjysma e kapitalit  
themltar drejtoria detyrohet brenda kater muajve nga miratimi i bilancit  
financiar ku eshte zbuluar kjo humbje, te therrase mbledhjen e asamblese  
se jashtezakonshme, me qellim qete marre vendim ne se ka vend per prishje  
te shoqerise.

Vendimi i likuidimit te shoqerise duhet te behet njohur gjithese  
aksionereve te shoqerise nepermjet publikimit te tij ne njetet e infor-



Neni 92

Aksioneret qe zotrojne aksione ne masen qe lejon pjesmarrjen e tyre ne asamble,kane te drejte te kundershtojne ne rruge gjyqesore vendimin e marre nga asambleja e jashtezakonshme per likuidimin e shoqerise.

Neni 93

Akti i mbylljes se likuidimit te shoqerise se bashku me llogarite perfundimtare depozitohen ne rregjostrin tregtar.

Mbas mbylljes se likuidimit dhe depozitimit te dokumenteve ne rregjistrinin tregtarshoqeria qrrregjistrohet prej tij.

XIII.DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 94

Padia e ngritur per anullimin e shoqerise ose akteve te shqyrtuara pas themelimit te saj parashkruhet per 3 vjet,duke filluar nga dita kur vendimi i anulimit ka hyre ne fuqi.

Neni 95

Nepunesit e shoqerise si dhe te ngarkuarit me pune prej saj ose nga asambleja e aksionereve dhe persona te tjere qe punojne per llogari te saj mbajne pergjegjesi penale,kur konstatohet se me dashje shkelin detyrat e ngarkuara qe i shkaktojne humbje shoqerise ose me ndergjegje paraqesin t dhena te paverteta.

Neni 96

Mbas nenshkrimit te tij statuti legalizohet ne noteri dhe hyn ne fuqi mbas rregjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregtar prane Gjykates se shkalles se pare te rrethit gjyqesor Tirane.

O R T A K E T

1.KOSTA ÇIBUQI 2.YLLI BRAKA 3.ILIAZ FISHEKU